



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 583/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën subjektit politik Bashkimi Demokratik (BD) dega në Prizren, paraqitur kundër Qendrës së Numërimit të Rezultateve (QNR), për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Hidhet si e parregullt ankesa e Bashkimit Demokratik (BD) dega në Prizren.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Bashkimi Demokratik me datë 04.11.2013, në të cilën ka pretenduar se, në të gjitha klasat përkatëse në qendrën e votimit 2007 A. nga komisionerët e partive tjera politike kanë ndodhur parregullsi që janë evidentuar nga vëzhguesit tonë dhe krejt kjo ka ndodhur pasi që e kanë shfrytëzuar mungesën e komisionarëve tonë. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar që të numërohen votat e shpallura si të pa lejueshme.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi rregullsinë e ankesës gjeti se:

ankesa është e parregullt

Me ankesën e parashtruar nga BD-ja pretendohet se në të gjitha klasat përkatëse në qendrën e votimit 2007A nga komisionerët e partive tjera politike kanë ndodhur parregullsi që janë evidentuar nga vëzhguesit tonë dhe krejt kjo ka ndodhur pasi që e kanë shfrytëzuar mungesën e komisionarëve tonë.

PZAP-i konstatoi se, ankesa është e parregullt pasi që ankesa nuk e përmban vërtetësinë e saj nga pala ankuese, andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 3.6 pika d, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 583/2013 më datën 06.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda një-etekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*